

RELACIONI TEKNIK

Objekti : Rikualifikimi I rrugëve të brendshme "Turizem – Kanali i Cukes" Sarandë "

Ne kete projekt jane parashikuar vazhdimi i rruges me nje gjatesi 684 ml dhe me gjeresi variabel 9-10.0 m sipas terrenit egzistues te rruges si dhe objekteve qe shtrihen pergjate rruges . Rruga eshte vazhdim i dy loteve te meparshme e cila ka ardhur deri ne piken 0+000 te fillimit te ketij projekti i cili shtrihet ne nje zone urbane, ne te dy anet rruga kufizohet me mure rrethues te avllive si edhe objekte te cilat e kane reduktuar ndjeshem hapesiren e rruges. Ne gjendjen ekzistuese rruga paraqitet e degraduar ne pjesen me te madhe te saj nga ndertimet pa kriter si edhe zaptime te ndryshme te tyre..

Kjo rruge "13 Birbilenjte" vazhdim i saj ndodhet ne zonen e quajtur Turizem-Kanali Çukes , Sarande.

Projektimi i rruges te brendshme me asfalt ne Turizem-Kanali Çukes perfshin nderhyrje ne infrastrukturën rrugore duke kryer zgjerimin e trupit te rrues ndertimin e disa mureve mbajtese prej betonarme me nje lartesi variable nga 2-5.00m lartesi, kemi prishje te shtresave rrugore te hedhura vende vende aty ku ka pjerresi te medha si edhe disa shtresa te vogla asfaltike.Vazhdimi i kesaj rruge kosiston ne zgjerimin e saj aty ku eshte e mundur dhe mirekuptueshme nga banoret qe jane permbri rruges, ndertimin e mureve mbajtese, prishjen e disa mureve mbajtese te vjetra prej guri zgjerimin e saj ndertimin e veprave te artit, ndertimin e kanalizimeve te KUZ si edhe ojeserisht e Ujit te pijshem aty ku eshte rrjeti i demtuar ose i pashtuar. Kemi ndertimin e kanalizimit te ujrave te shiut permbri rruges sistemimi i tyre dhe largimi.Kjo eshte e domosdoshme per tu ndertuar pasi lakmia e banoreve e ka cunguar pothuajse gjate gjithe gjatesise si edhe ndertimin e rrugeve hyrese ne objekte mbi rrugen egzistuese si edhe te rrethimeve te oborrove private oarkimeve pa kriter dhe zaptimeve pa kufi . Rruga shtrihet ne terren shkembor kat 3 shkemb i forte dhe me pjerresi te medha qe arrijne deri ne 20%

Qëllimi i projektit konsiston ne përmirësimin e mjedisit urban, krijimin e hapësirave me miqesore per funksionimin e kësaj rruge si infrastrukture e mirefillte bashkekohore dhe kthimin e saj ne shërbim te komunitetit, duke qene se eshte nje rruge qendrore me impakt te drejtperdrejte per banoret e kesaj zone .

Përfituesit direkt te projektit janë banoret e zonës dhe pushuesit e huaj dhe vendas qe zgjedhin te kalojne pushimet e tyre ne keto zona turistike.

Sic duket edhe nga fotot si me poshte:










Pershkrimi gjurmes se rruges: Keto segmente qe do trajtohen ne kete projekt kane nje gjatesi 684ml dhe parashikohet ndertimi i nje rruge me gjeresi asfaltike, me shtrese asfaltike asfalto betoni 4cm dhe binder 6cm ne nje gjeresi trupit te rruges 5.00m. Gjithashtu eshte parashikuar ndertimi i dy trotuareve nga te dyja anet e rruges Paketa e plote per ndertimin e kesaj rruge perbehet nga shtrese stabilizanti 15cm, shtrese cakelli 20cm, asfaltobeton 4cm dhe binder 6cm. Duke patur parasysh se eshte nje rruge e re qe po investohet per ndertimin e saj nga e para eshte pare e mundshme edhe rehabilitimi i parametrave gjatesore te rruges pjerresise kurbave vertikale si edhe ato horizontale duke e bere te aksesueshme per gjithë gjatesine e saj Po paraqesim profilin terthor tip qe do te zbatohet ne kete rruge



Jane parashikuar edhe kanalizimet, ndricimet e rruges nga te dyja anet me kollona te thjeshta metalike me $h=9.00m$ mbjellejen e pemeve nga te dyja anet e rruges si edhe shtrimin e tubacioneve ne trotuar per rrjetet e mevonshme te telekomunikacionit si edhe cdo gje tjeter. Ky objekt paraqet veshtiresi prandaj edhe autoriteti vendor dhe banoret do te kene mirekuptimin dhe dakortesine e nderhyrjeve per te aritur parametrat e rruges.

Qellimi kryesor i projektit eshte te permiresoje mjedisin urban, te krijojë hapësira miqësore per funksionimin e ketij blloku banimi si infrastrukture e mirefillte bashkekohore dhe kthimin e sa ne sherbim te komunitetit.

Do te hartohet projekti ne teresine e vet duke perfshire infrastrukturen siperfaqesore. Perfituesit

direkt te projektit janë banoret dhe frekuentuesit e zonës.

Ky studim synon te beje te mundur sigurinë e lëvizjes mbi kete rruge te kembesoreve dhe te mjeteve si dhe do te ndihmoje ne shmangien e problemeve ne te ardhmen. Studimi do te mundesoje analizimin e problemeve ekzistuese si dhe dhënien e zgjidhjes opsionale.

Projekti është hartuar në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave. Projektuesi mund të rekomandoje edhe prezantimin e standarteve të reja për përcaktimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmerisë me praktiken shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës e cila konsiston ne rikualifikimin e infrastruktures rrugore, krijimin e hapësirave me miqesore per funksionimin e kesaj rruge si dhe infrastrukturen e mirefillte bashkekohore dhe kthimin e saj ne sherbim per komunitetin dhe pushuesve te huaj dhe vendas qe frekuentojne keto zona